Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
07 -04- 2021
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 1086-2021

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63, nenit 12 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të nenit 8, germa b) e Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 7 prill 2021 merr këtë:

VENDIM

për çregjistrim të partisë politike Partia Demokratike e Diasporës-PDD

I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çregjistrimin dhe largimin nga regjistri i partive politike të partisë politike "Partia Demokratike e Diasporës-PDD", për mosdorëzimin e Formularit për vazhdimin e regjistrimit në pajtim me nenin 7 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

II. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike "Partia Demokratike e Diasporës-PDD", për marrjen e këtij Vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Partia politike, "Partia Demokratike e Diasporës" me akronimin PDD e regjistruar më 08 gusht 2019, nuk ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 7 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht nuk e ka dorëzuar Formularin për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike që duhet të dorëzohet deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik.

Këshillë juridike: *Partia Politike, "*Partia Demokratike e Diasporës*" me akronimin PDD, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për çregjistrim nga regjistri i partive .*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Për

Valdete Daka, Kryetare